

TRASHËGIMIA (pjesa 4)

Bëj Çdo Gjë Me Qëllim!

Shumicën e herëve ne jemi të qëllimshëm për shumë gjëra dhe i planifikojmë me kujdes. P.sh. kur ke një ditëlindje ose Shën Valentin, ditën e mësueses, nënës, apo kur dikush ka dasmë, duhen ditë e orë të tëra për të përgatitur një event 40-45 minutësh.

Apo kur një çift pret fëmijë, përgatit shumë gjëra me detaje. Gjen emrin, përfshin edhe të tjerë në gjetjen e emrit, ngjyrën e dhomës, madje disa i bëjnë dhomat me “themes”: “Barbi”, “Elsa”, “Frozen”, “Spiderman”, “Ironman”, gjithë seti i “Marvel Movies”.

Ne e kishim “Spiderman” dhe me ngjyrat blu dhe të kuqe! Boo! Lyerja e dhomës më ka dhembur më shumë, sepse për ta bërë ngjyrën blu të errët apo të kuqe të errët duhej shumë pigment, një kovë bojë kushtonte shuuuumë lek!

Kjo ishte për fëmijën e parë. Sa mirë që i dyti ishte djalë prapë, që mund të rrinin në një dhomë, imagjino të kishim vajzë!

Fëmija i parë ka sfida, por ka edhe përfitime.

P.sh biberoni, me fëmijën e parë, nëse ndodh që bie në tokë, hidhet në kosh, s'bën më, do blejmë tjetër. Me të dytin e lan dhe është në rregull, ose sa i fryn një çikë. Prit, se harrova mesazhin...

Çdo Gjë Me Qëllim. Disa herë i japim rëndësi disa gjërave që s'kanë ndonjë vlerë të madhe dhe lëmë pas dore ato që kanë shumë rëndësi.

Si t'u japim TRE gjëra me qëllim brezit tjetër, që të kenë sukses në anën frymërore. Nëse nuk u japim diçka me qëllim, ka gjasa që do marrin diçka tjetër, padashje.

Ja tre gjëra që ua japim padashje (e nisim me dëshirën e mirë, por rrugës bëjmë më shumë dëm se mirë):

U japim merita që s'u takojnë

“Të lumtë! Ti je më i miri në gjithë qytetin! Ky është provimi më i saktë që kam parë në jetën time! Kjo është gjuajtja më e bukur! Më bukur se kaq s'kam parë / s'kam për të parë!”

Kur u japim lavdërime të ekzagjëruara, po u japim një këndvështrim jo të duhur të realitetit.

E dyta që u japim:

U japim gjëra që nuk i kanë fituar

E përmenda në pjesën e parë, por do e cek edhe pak sepse është diçka që po zmadhohet përditë. Çdo gjë po zmadhohet, ekstravaganca ka arritur në kulm. Nëse nuk më beson hyr në “Pinterest” dhe shkruaj: “Dua të bëj një super ditëlindje për djalin tim 1 vjeç.” Do të habitesh sa shumë ide, pafund zbukurime, çfarë të duash. A do edhe një grup që të bëjë numra shpejtësie, a do 20 veta të veshur me kosutme dhe pafundësi formash të tortës së ditëlindjes?

Dhe të vjen t'i thuash: *“O prind i dashur, më duket se po i bën për vete, për t'ia kaluar dikujt apo për të treguar diçka? Se çuni yt një vjeç bën. Ai nuk kupton shumë gjëra dhe nuk do të mbajë mend shumë gjëra”.*

Disa njerëzve, kujtimet më të hershme që mund t'i sjellin në mendje janë 4, 5 vjeç, shumica kujtimet më të hershme i kanë me klasën e parë dhe pas.

Si mund të marrë dikush kredi për ditëlindjen e fëmijës një vjeç, kur duhen pesë vite ta shlyesh kredinë dhe e ka paguar dy-trefish! Dhe pastaj kur bën pesë vjeç, i blen iphone 1,000 euro? Fëmija akoma nuk e di vlerën e njëmijë lekëve, ti i jep në dorë diçka që bën njëmijë euro! Dhe sa herë që u jep gjëra që s'e meritojnë, ata do krijojnë idenë që *"ti ua ke për detyrë dhe po e vonon një çikë atë që ai/ajo 'meriton'"*.

Se mbaroi klasën e parë tjetri, i duhet biçikleta "I-bike" dymijë euro! Ai po bën plane për avionin personal kur të bëjë 15 vjeç! Çfarë ndodh? Zero mirënjohje, *"100% ma kanë për detyrë, madje të më rrinë 'pronto' dhe të më bëjnë fresk!"*

E treta:

U japim liri që s'dinë si ta menaxhojnë

"Çuni im është i rritur tani, është 6 vjeç dhe mund të luajë 'play station' sa orë të dojë dhe çfarë loje të dojë. Mund të rrijë në telefon derisa të lodhet vetë".

Kur janë adoleshentë dhe plot hormone ti u thua:

"Bëj qejf të keqen mami, se je i/e rritur tashti". Kur shkojnë për një mbrëmje apo natë mature, si e kupton një adoleshent atë lloj lejeje *"bëj çfarë të duash"*, se jam kurioz, po them për adoleshentët tani, se ne ashtu e kuptonim, *"fillo duke u bërë tapë si fillim, pastaj mos mbaj mend më asgjë se çfarë ke bërë, por sigurohu që s'ke lënë gjë pa bërë"*.

Nuk mendoj që një adoleshent, kur i thua sot *"bëj qejf"* e kupton: *"Shko në party, merr një Cola, hamburger me patate dhe në orën 9 hajde në shtëpi"*.

E di që po e ekzagjeroj, por nuk janë aq të maturuar sa ç'mendon për moshën që kanë, nuk mund t'u japësh liri pafund sepse ata edhe me qëllimet më të mira, nuk dinë si të sillen me lirinë e pakufizuar. Mos pa e kuptuar, po e lëndojmë brezin e ri me duart tona?

Prandaj, le të mos ia lëmë rastësisë, le t'ua japim gjërat me qëllim. Asnjëri nga ne, asnjë i ri apo adoleshent nuk do bëhet i mirë rastësisht apo i dashur apo i perëndishëm. *"I hodhi mami një çikë kripë dhallit, sa e piu, u bë si shpirt çuni!"* Nuk ndodh rastësisht: *"Më ngeci këmba te Bibla dhe u rrëzova, kur u ngrita, isha bërë 100% i shenjtë."* Nuk ndodh ashtu.

Le të jemi të qëllimshëm, çfarë bëjmë vetë dhe çfarë i japim brezit tjetër, që t'i ndihmojmë të rriten frymërisht.

Tani, ne s'i kontrollojmë dot veprimet e tyre, por ama mund ta kontrollojmë se ku i çojmë, ku i ekspozojmë, se çfarë u japim. Këto mund t'i kontrollojmë.

Dua të shikojmë një gjë unike nga libri i pestë i Biblës, jo një gjë, por tri gjëra në fakt. Si të jemi të qëllimshëm, që t'i japim brezit të ri tri gjëra me qëllim:

Ligji i Përtërirë 6:4 *'Dëgjo, Izrael, Zoti, Perëndia ynë, është një i vetëm.'*

Ligji i Përtërirë 6:5 *'Ti do ta duash, pra, Zotin, Perëndinë tënd, me gjithë zemër, me gjithë shpirt dhe me tërë forcën tënde.'*

Ligji i Përtërirë 6:6 *'Dhe këto fjalë që sot po të urdhëroj do të mbeten në zemrën tënde;'*

Ligji i Përtërirë 6:7 *'do t'ua ngulitësh bijve të tu, do të flasësh për to kur rri ulur në shtëpinë tënde, kur ecën rrugës, kur ke rënë në shtrat dhe kur çohesh.'*

Ligji i Përtërirë 6:8 *'Do t'i lidhësh si një shenjë në dorë, do të jenë si shirita midis syve,'*

Ligji i Përtërirë 6:9 *'dhe do t'i shkruash mbi pllakat e shtëpisë sate dhe mbi portat e tua.'*

Nga ky pasazh le të shikojmë 3 gjëra, që t'i kemi për vete, për ju që jeni të rinj dhe t'ia japim brezit tjetër.

1 - T'u Japim Një Komunitet Për Së Mbari

Si ishte vargu i parë?

Ligji i Përtërirë 6:4 *'Dëgjo, Izrael, Zoti, Perëndia ynë, është një i vetëm.'*

I drejtohet kombit, që i bie, ky ishte besimi i një kombi, i të gjithëve si popull. S'ishte vetëm besim i pesë familjeve, por i të gjithë kombit. Të gjithë bashkë si komunitet besonin të njëjtën gjë, kishin vlera të njëjta të gjithë.

Shiko, në Dhjatën e Vjetër, familja ishte e madhe.

Nuk ishte si familjet sot, mami, babi dhe një fëmijë, maksimumi dy. Atëherë jetonin në një shtëpi të gjithë bashkë.

Unë mbaj mend diçka të ngjashme sepse deri kur isha 9 vjeç, në klasën e tretë, ne kemi jetuar në një shtëpi dy familje dhe gjyshja. Prindërit e mi, plus gjashtë fëmijë dhe xhaxhi me tetën dhe ata gjashtë fëmijë, plus gjyshja, plus një kushërirë e babit në total ishim tetëmbëdhjetë veta në një shtëpi. Mbaj mend edhe familje më të mëdha me 4-5 çifte të martuara me fëmijë dhe një familje dhe ishte diçka normale!

Kultura e Izraelit, në Dhjatën e Vjetër, ngjan shumë me kulturën tonë sepse jemi mesdhetarë dhe kulturat tona ngjajnë shumë.

Familja për ta ishte si një komunitet me 20-30-50 veta, madje mund të ishte deri në 100 veta një familje. Sepse kishin dhe ndonjë që punonte për ta, kishin edhe ndonjë të fisit që jetonte me ta. Dhe të gjithë si komunitete kishin të njëjtin besim, të njëjtat festa dhe këto familje bashkë bënë gjithë kombin e Izraelit.

Për ne si të krishterë ungjillorë, kisha jonë është familja jonë, fisi ynë, komuniteti ynë dhe kisha tjetër ungjillorë është një familje tjetër, një komunitet tjetër, por të gjithë bashkë, bëjmë kishën e madhe, trupin e madh të Krishtit. Dhe bashkë bëjmë mbretërinë e Perëndisë, ku mbret është Krishti.

Por ne si komunitet ngjajmë në shumë gjëra me kishat e tjera, gjithashtu kemi edhe disa gjëra specifike tonat. Ashtu siç familjet ngjajnë me njëra-tjetrën, po ashtu secila ka disa gjëra specifike të vetat.

Prandaj shpesh, kur dikush shkon në një kishë tjetër thotë: *"Nuk më ngjiti shumë, s'ishte si kisha jonë, edhe pse bënë të njëjtat gjëra si ne, nuk ishte si e jona."* Po, sepse kemi specifikat tona si familje, jemi njëlloj, por kemi atë "llojin" tonë, që na bën unikë.

Shiko, kjo familje, me këtë llojin "unik", nuk ka ndodhur vetvetiu, por kemi një besim dhe kemi të njëjtat vlera. Ndërkohë që shumica po vlerëson pavarësinë dhe të ndenjurit vetëm, ne çmojmë të mbledhurit bashkë.

Ka prindër që thonë: *“I bën mirë fëmijës të rrijë vetëm në shtëpi se mësohet i pavarur. Nuk duam që të varet nga të tjerët. S’duam t’ia ketë nevojën askujt.”* Duket sikur pavarësia po lartësohet mbi shumë gjëra të tjera.

Shiko, të jesh i pavarur nga të tjerët, do të thotë të mos jesh ndjekes i Krishtit, sepse Krishti do që të jemi të lidhur, do që të jemi të varur, do që t’ia kemi nevojën njëri-tjetrit. Ai ka vënë në Bibël pesëdhjetë e ca urdhërime në lidhje me njëri-tjetrin. Si trupi fizik që ka nevojë për kontributin e të gjithë gjymtyrëve që të jetë i gjallë dhe aktiv. Kështu edhe të krishterët janë trupi, ku Krishti është koka.

Shkrimi thotë *ta duam njëri-tjetrin, kujdesemi, lutemi, ndihmojmë, inkurajojmë, mbajmë barrët, të përkushtuar ndaj njëri-tjetrit, të duruar, ta falim njëri-tjetrin, të mëshirshëm, ta përshëndesim, madje përshëndeteni njëri-tjetrin me puthje të shenjtë (kjo me puthje të shenjtë, se di si bëhet, por i japim dorën njëri-tjetrit) më e mira do ishte ta përqafojmë njëri-tjetrin kur shihemi.*

Shiko, kur ti e ke mendjen, kur e bën me qëllim, e merr mundimin të krijosh, të investosh te një komunitet i tillë për vete dhe familjen tënde, kjo të mbledhurit bashkë ka super fuqi, super ndikim, te ty dhe te familja jote.

Dhe shiko, kur ti dhe fëmijët e tu, jeni pjesë e një komuniteti të tillë dhe dikush thotë: *“Ooo, ti po ti, vetëm ti në gjithë qytetin paske Bibël, vetëm ti shkon në kishë, vetëm ti bën këtë, s’bën atë...”* Por ti thua: *“Jojo s’jam vetëm, jam si Noizy me 30 vetë, madje më shumë! Ka shumë si unë, që e duan Perëndinë, besojnë te Krishti Jezus, si Zot dhe Shpëtimtar. Ka qindra apo mijëra në qytet/fshat si unë.*

Çfarë duhet t’u bëj qëllimisht atyre që janë pjesë e një komuniteti për së mbari këtu dhe kudo që ndodhen? Kur dikush ikën nga kisha jonë nëpër botë, së pari mundohemi që t’i lidhim me një kishë lokale afër shtëpisë. Nëse nuk ka, i nxisim ta kthejnë dhomën e ndenjes në kishë, duke ndjekur festime online të kishës.

Cila është e dyta, sepse duam të lëmë tri gjëra qëllimisht:

2 - Një Standart Për Së Mbari

Ligji i Përtërirë 6:5 *‘Ti do ta duash, pra, Zotin, Perëndinë tënd, me gjithë zemër, me gjithë shpirt dhe me tërë forcën tënde.’*

Cili është standarti yne? Sipas këtij vargu, nuk është, *“hajt mo, sa për sy e faqe”*, por do ta duam Perëndinë me gjithë zemër, me gjithë shpirt, me gjithë forcën tonë.

Ta duam me 100% tonë.

Prit tani, se do habitesh me këtë që do të them tani: Fëmijët hebrenj në Dhjatën e Vjetër, s’mësonin disa vargje përmendësh, por mësonin gjithë Torën përmendësh, pesë librat e parë të Biblës dhe duhet ta kishin mësuar para se të bëheshin dymbëdhjetë vjeç. Kush është gati ta provojë? Çdo fëmijë mund ta bëjë nëse i thua që ai /ajo mundet!

Por pas Dhjatës së Re, pas ardhjes së Krishtit, jetojmë në kohën e hirit dhe nuk është e nevojshme të dimë përmendësh 5 libra të Biblës apo 66-të, gjithë Biblën. Kemi nevojë të dimë përmendësh dy urdhërime dhe t’i praktikojmë ato përditë.

-Duaje Perëndinë me gjithë zemër, shpirt, forcë, mendje.

-Duaje tjetrin porsì veten.

Aryseja pse po e theksoj këtë është sepse: Kur e ngre standartin, do të habitesh se çfarë mund të bëjë njeriu. Sot, njerëzit po e ulin poshtë e më poshtë standartin, aq sa po kërkohet minimum i sakrificës ose tepricat, *“po munde bëj diçka, po të ngeli kohë bëj diçka”*.

A e di se fjala adoleshent ka më pak se 100 vjet që është përdorur? Ka filluar rreth viteve 1940. Deri atëherë kishte dy breza, fëmijë dhe të rritur.

Pali tha te

1 e Korintasve 13:11 *'Kur isha fëmijë, flisja si fëmijë, mendoja si fëmijë, arsyetoja si fëmijë; kur u bëra burrë, i flaka gjërat fëminore.'*

Ai nuk tha, isha fëmijë, pastaj u bëra adoleshent, që do të thotë, dukesh si burrë, por mund të sillesh dhe si fëmijë?

Ajo që kemi bërë ndër vite është se kemi krijuar kategori të rriturish, madje dhe nënndarje brezash me 15 vite diferencë mes tyre, “GenX”, “Millennials”, “GenZ” dhe “GenAlfa”.

Rrjedhimisht çdo grupmoshë kërkon të drejtat e veta dhe sa më pak përgjegjësi.

Dhe kështu ka të rritur 30 vjeçarë që duan të sillen akoma si 13.

Por ama, ka mes tyre që janë 13+ dhe janë “zjarr”, veç

jepu një sfidë, veç thuaju se çfarë të bëjnë dhe do të

bëjnë namin!

Jezusi kur erdhi nuk e uli standartin, Ai e ngriti më shumë atë. Te Dhjata e Vjetër thuhet: *“Mos vrit”*, por Jezusi, e ngriti standartin: *“As mos e urre dikë”*, fike që në mendim.

Te Dhjata e Vjetër thuhet: *“Mos kryej tradhëti bashkëshortore”*, Jezusi e ngriti standartin: *“As mos e dëshiro në mendje”*, fike që kur do të vijë si epsh.

Që i bie, nëse je ndjekës i Krishtit, ti je “zjarr” aty ku je! Nëse je në punë, ti je 100% në punë dhe jep maksimumin tënd sepse e ke standartin e lartë, e bën punën si për Zotin. Nëse je në shkollë, je 100% aty sy e veshë në shkollë dhe je “zjarr” me notat dhe vëmendjen në shkollë. Nëse je i lidhur, e nderon atë si virgjëreshë, si princeshë. Nëse je i martuar, ti je super partner, mendon për të më shumë sesa për vete. Ai e ngriti shumë lart standartin! Këtë na thotë dhe ne: *“Atë që bën, bëje me 100% pasion. Ti nuk e njeh fjalën “Ndoshta” as “Pjo”*.

Kur i flet vetes ose fëmijëve, mos u thua: *“Shkoni në shkollë, mundohuni të jeni si të tjerët, jini njerëz të mirë si të gjithë. Ose në punë, jini si të gjithë.”*

Jo, ngrije standartin: *“Kur të shkosh në shkollë/ në punë, mos harro se je ti drita e botës, ti je kripa, shija e bisedave. Krishti banon në ty. Sill ndikim aty ku je. Ti s'je viktimë, ti sjell ndikim aty ku je. Nuk bëhesh ti si ata, ata bëhen si ty, nga ndikimi yt.”*

Ngrije standartin. Jo thjesht “çikë më mirë” se shumica. Jo, jo, shumë më lart nga shumica!

Nuk iu thua, *“Po ja, shkojmë në kishë ndonjë të diel kur të na lërë mami”*. Jo, jo, e diela është kishë, është dita që adhurojmë Zotin si familje. Është diell, është shi, bie hekur, bie borë, jemi të lodhur, jemi të çlodhur, nuk duhet të bëjmë kompromise.

Sepse ti e di që ti je kisha. Ti je pjesë e kësaj familjeje, po s' shkove ti është sikur trupit i mungon një pjesë, një sy, një vesh, një gisht, një gjymtyrë. Ti je kisha!

“Unë dua të shërbej te kisha, - më tha dikush - por kur të kem kohë të lirë.”

“Jo, jo. Nuk e duam, - ashtu i thashë, - ne japim më të mirën, o vijmë dhe japim 100% ose nuk vijmë. Nuk ka ‘Pjo’. Thuaj, sa mund t'i japësh kishës, dy orë në javë, tri orë në javë, ku mund

të shërbesh? Por s'mund të jetë 'Pjo' sepse shërbesa jonë bëhet për Zotin, jo sikur po 'shet fara luledielli'.

-A ke blerë fara para një ndeshjeje, sa bënë?

-Po nja 100 ose 200 lek. Më jep sa t'më japësh. Jep për dy, të mbush tre."

Jo, jo, është qejf, është privilegj, është gëzim, t'i shërbesh shumë të Lartit me ato dhunti që të ka dhënë. Ngrije standartin: Në vend t'i thuash vajzës adoleshente, "bëj qejf të keqen mami, veç me masa mbrojtëse, mos më hajde shtatzënë në shtëpi". Jo, jo, thuaji: "Ruaje virgjërinë për burrin e ardhshëm, ajo është dhurata më e bukur që mund t'i bësh atij."

Një djalë më tha njëherë: "Po ajo s'është më e virgjër se ashtu ka qenë një muhabet më para."

-Atëherë ruaje ti, trajtoje ti, si virgjëreshë, si princeshë!

Më beso, të rinjtë e sotëm nuk janë "qullo", janë "zjarr". Jepu një standart të lartë dhe do e nderojnë atë! Në vend që t'i thuash, "Po s'ka gjë se adoleshent je ti, rri luaj 'video-games' nja 10-15 vjet, pastaj mëso ndonjë zanat për jetën", jo, jo, "Ti je i rritur, prandaj 'Duaje Zotin Perëndinë fort, me çdo gjë që ke, me gjithë zemër, me gjithë shpirt, me gjithë forcë, me gjithë mendje/logjikë'. Jo si besim i vakët, as mish as peshk, por i plotë, i bukur, i zjarrtë, i pastër". Të rinjtë, nuk janë e nesërmja. Jo ore jo. Të rinjtë janë e sotmja! Sa më lodh ajo thënia gjoja motivuese:

"Të rinjtë janë e ardhmja". Jo!

Të Rinjtë Janë e Sotmja

Ti je "flakë", ti ke çdo gjë që të duhet për të nderuar emrin e Zotit Jezus sot! Ngrije standartin për vete dhe për familjen tënde dhe shiko se çfarë do të ndodhë.

Cila është e fundit, pra, duam t'i japim vetes dhe ta pasojmë te brezi i ri një Komunitet për së mbari, një Standart për së mbari dhe

Një Besim Për Së Mbari Që Shumëfishohet

Do ia ngulisim mendjes tonë së pari dhe familjes tonë. Kur mund të flasësh për këto gjëra?

Ligji i Përtërirë 6:7 *'do t'ua ngulitësh bijve të tu, do të flasësh për to kur rri ulur në shtëpinë tënde, kur ecën rrugës, kur ke rënë në shtrat dhe kur çohesh.'*

Do të flasim kur hamë darkë, do flasim kur i vëmë në gjumë, do të lutemi me ta. Do flasim në mëngjes, kur i përcjell te furgoni i shkollës, çdo lloj momenti.

Do flasim rrugës për te kursi i muzikës, sportit, anglishtes, matematikës, baletit, kitarës, çfarëdolloj kursi. Do ua tregojmë sesi jetohet besimi në çdo copëz të ditës.

Se shiko, ka shumë gjasa që të gjithë të rinjtë apo fëmijët tuaj, ata e nuhasin kur diçka është "fake" (fallco). Ata e kuptojnë direkt kur një celular është "fake", kur një rrobë është "fake", kur atletet janë "fake".

Dhe, ata e nuhasin direkt nëse besimi yt është "fake", fallco, sa për sy e faqje.

Të jesh vetja është më e veçantë sesa të hiqesh.

Brezi i ri të ka qejf nëse je i qetë, i shtruar, të ka qejf edhe kur je i zjarrtë. Por nuk i duan gjërat e vakëta, një herë ashtu, një herë kështu.

Askush s'e do kafën e vakët, çajin e vakët, akulloren e qullët, Colën e ngrohtë, picën e ftohtë, pilafin e vakët, fasulet e vakëta, etj. O të nxehtë, o të ftohtë, jo të vakët.

Ta them një sekret, por mos ia thuaj njeriu:

As Zoti s'i do gjërat e vakëta! Te Zbulesa Ai thotë:

“O ji i zjarhtë, o ji i ftohtë, vetëm i vakët jo.”

Hipokritët kanë dalë nga moda. Po bëre gjasme, të rinjtë e nuhasin me erë. Troç fare, çfarë do për vete ose për fëmijët e tu:

-A do që ta duan shumë Biblën? Kanë nevojë të të shohin ty që e do fort Biblën.

-A do që të luten për çdo gjë? Kanë nevojë që të të shohin ty që lutesh për çdo gjë.

-A do që të ndajnë lajmin e mirë, me kohë e pa kohë? Kanë nevojë që të të shohin ty.

-A do që ta vlerësojnë të ardhurit në kishë të dielën? Kanë nevojë të të shohin ty që vjen me qejf çdo të diel.

-A do që të bëjnë diçka me gëzim te kisha? Kanë nevojë të të shohin ty që bën diçka dhe e bën me gëzim.

-A do që të jenë të zotë me menaxhimin e lekut, kohës, ditëve? Duan ta shohin tek ty.

-A do që të jenë bujarë? Duan ta shohin te ty.

-A do që të jenë ndjekës të zjarhtë të Krishtit? Duan ta shohin te ty.

Ata nuk duan të shikojnë perfeksion, por ama duan të shohin pasion. Duan të shohin si e kërkon ti Zotin në ditë të vështirë dhe nuk të ikën “zari” për çdo shqetësim.

Besimi në Krishtin Jezus nuk është si fe e lodhshme:

“Po jemi dhe ne të krishterë të keqen babi/ mami”.

Jo, jo, të flasë vetë gjëja dhe ta duan vetë brezi i ri:

“Kur të rritem unë do bëhem si babi, si babi im.

Unë do bëhem si mami, si mami im.

Unë do e dua Zotin, do shërbej, do jap, do tregoj, çdo gjë do ta bëj si babi/mami im.”

Dhe ky quhet besim për së mbari, që riprodhohet.

E ke ti, e marrin ata, ua përcjellin të tjerëve.

Kur djali im ishte i vogël, 5-6 vjeç, më tha: *“O ba, unë dua të bëhem si ty.”*

-Oo sa mirë, - i thashë - do të bëhesh predikues?

“S’ e di ç’ është predikimi, por dua të bëhem si ty.” Do të bëhesh pastor, më shikonte, *“pastor, s’ e di ç’ është, por dua të bëhem si ty”.*

Do të më gëzonte shumë nëse djemtë e mi do të ndiqnin rrugën time, por s’do të doja kurrë të ndjenin presion. U them: *“Mbajeni dorën hapur para Perëndisë, mos thoni ‘e dua patjetër’, mos thoni, ‘në botë nuk e dua’.”* Thoni:

Perëndi, çfarë do Ti nga unë!

Kjo është për të gjithë, jo me zor, jo se kështu thotë babi. Ta dëshirojnë vetë dhe e dinë që Zoti ka të njëjtën gjë për ta.

Koha e Rrëfimit: Për të thënë të vërtetën, unë s’ndihem çdo ditë sikur e nderoj Zotin çdo ditë apo jam baba i mirë çdo ditë apo burrë i mirë apo shok i mirë apo lider i mirë çdo ditë. Ndhem sikur kam zhgënjyer shumë njerëz herë pas here, sidomos familjen. Sepse ka raste, që unë s’e praktikoj vetë 100% atë që them.

Shumë herë hallakatem, shpesh ndihem i lodhur, i stresuar, ka ditë që jam me nerva ose pa motivim, përtoj të bëj gjërat edhe më të vogla në shtëpi. Ndjej zemërim ndonjë herë, ka netë që fle gjumë pa u pajtuar me gruan time. Ai vargu “pajtohu pa perënduar dielli”, na ka zënë ca herë pa u pajtuar etj... gjëra të tilla.

POR ama kjo që ju them, është ajo që thotë Shkrimi. DHE... mua, ty, ne, na duhet ndihma e Frymës së Shenjtë. Nuk po hiqem si hero dhe s’dua të mendosh se jam i tillë. Unë kam nevojë të rri i lidhur me Zotin përditë. Si ti!

Nuk dua që ndonjëri të ndihet, “*ja këta e kanë në terezi, po ne që s’i kemi gjërat në vijë fare*”. Shiko, Perëndia ka bërë, po bën dhe do të bëjë gjëra të bukura në kushte jo të persosura. Perëndia po bën diçka të re, të bukur tek jeta e secilit prej nesh. Mos e dëno veten, prandaj po e them këtë rrëfim. Jemi të gjithë njëloj, kemi të gjithë të njëjtën Frymë të Shenjtë, kemi njëri-tjetrit, kemi Biblën.

E para, cila ishte: Komunitet për së mbari! Mos thuaj, “*varja, nuk e bëj dot këtë*”. Nuk është “takati” jonë, por është fuqia e Frymës. Thuaj me fuqinë tënde: “Perëndi, unë e dua dhe do ta dua fort këtë familje, këtë komunitet.”

Nëse nuk e ngre dot standartin në maksimum, ngrije 1%, bëj diçka, vetëm një gjë më mirë këtë herë.

Dhe s’je vetëm. Jemi bashkë! Jemi familje! Jemi kisha, bashkë. Nuk është besimi im, besimi yt, është besimi Ynë, nuk është familja ime, familja jote, është familja Jonë. Nuk është Zoti yt, Zoti im, është Zoti ynë!

Fizikisht është familja jote, por në fakt jemi të gjithë të njëri-tjetrit. Jemi gjymtyrë në të njëjtin trup!

Edhe pse nuk jemi të përsosur, ne me qëllim bëjmë diçka sot, për të ndihmuar veten dhe për të pasur diçka te brezi i ri. Dhe kur çdo gjë të shkojë mirë, nuk do rrahim gjoksin, “jam unë”, “shih sa i mirë jam unë”. Por do të çojmë sytë lart dhe do të themi:

Je vetëm Ti, Ti je shumë i mirë!

Nuk duam ta shtyjmë këtë jetë, “*ça të bëj, hajt po e shtyj*”. Jo, jo! Ne lëmë trashëgimi me qëllim, lëmë vlera që do të zgjasin brez pas brezi, pas brezi. Një brez që e pason te tjetri besimin në Krishtin Jezus, bujarinë, dhembshurinë, dashurinë e sinqertë.

Dy janë mundësitë:

Hebrenjve 13:7 *'Kujtoni të parët tuaj, që ju shpallën fjalën e Perëndisë dhe, duke çmuar rezultatit e sjelljes së tyre, merrni si shembull besimin e tyre.'*

A do të lëmë këtë model, shembull?

Gjyqtarët 2:7b *'Populli i shërbeu Zotit gjatë gjithë jetës së Jozueut ...'*

Gjyqtarët 2:10 *'Kur tërë ai brez u bashkua me etërit e vet, mbas atij doli një brez i ri që nuk e njihnte Zotin, as veprat që kishte bërë për Izraelin.'*

Le të lutemi!